VENDIM
Nr. 116, datë 3.6.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË "OST" SHA PËR MIRATIMIN "E NJË UDHËZUESI PËR BALANCIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 16, 20, germat "a" dhe "ç", 23, pika 1, germa "a", 100, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016 të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE); Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.6.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1672/1 prot., datë 28.5.2025, të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së 'OST' sh.a. për miratimin e rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23 nëntor 2017, 'Për miratimin e Udhëzuesit për Balancimin e Energjisë Elektrike"',

konstatoi se:

- Shoqëria "OST" sh.a., me shkresën nr. 2580 prot., datë 30.4.2025, protokolluar në ERE me nr. 1672 prot., datë 5.5.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e rregullores së Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23.11.2017, mbi Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë Elektrike.
- Në këtë kërkesë, "OST" sh.a. informon se Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë, në mbledhjen e datave 14–15 dhjetor 2022, ka miratuar vendimin nr. 2022/03/MC-EnC, përmes të cilit kjo rregullore është përfshirë në *acquis communautaire* të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si pjesë e Paketës së Energjisë së Pastër.
- Rregullorja (BE) 2017/2195, e njohur si Udhëzuesi për Balancimin e Energjisë Elektrike (EBGL), përcakton një kornizë të përbashkët për funksionimin e tregjeve të balancimit në nivel evropian, me synimin për të rritur efikasitetin, konkurrencën dhe transparencën në treg, si dhe për të garantuar sigurinë e furnizimit.
- Rregullorja vendos rregulla për mënyrën e planifikimit, prokurimit, aktivizimit dhe shlyerjes së rezervave të balancimit nga Operatorët e Sistemeve të Transmetimit (OST), si dhe për përdorimin e rezervave zëvendësuese në rast të pamjaftueshmërisë së burimeve ekzistuese të balancimit.
- Gjithashtu, ajo përfshin dispozita për shkëmbimin ndërkufitar të energjisë së balancimit, format e pjesëmarrjes në treg për të gjithë aktorët përkatës dhe detyrime për bashkëpunim dhe raportim të të dhënave, me qëllim rritjen e transparencës dhe funksionimin e qëndrueshëm të tregjeve.
- Në përputhje me legjislacionin e Komunitetit të Energjisë dhe nevojën për harmonizim me rregullat e BE-së, ERE vlerëson të nevojshme nisjen e procedurës për shqyrtimin e kërkesës dhe organizimin e seancave dëgjimore dhe konsultimeve me palët e interesuara, përfshirë institucionet dhe aktorët e tregut të energjisë, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Udhëzuesit për balancimin e energjisë elektrike" miratuar me rregulloren e Komisionit (BE) 2017/2195, datë 23 nëntor 2017.
2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë

Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti